

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.I. nga fsh. ..., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit L.I., av. H.Sh., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore–DKR në Gjakovë, PKR.nr.47/14 datë 14.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, më datë 01.12.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.I., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore–DKR në Gjakovë, PKR.nr.47/14 datë 14.09.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – DKR në Gjakovë, PKR.nr.47/14 datë 14.09.2017, i akuzuari L.I., është shpallur fajtor për veprën penale grabitje nga neni 329 par. 1 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur edhe koha kaluar në arrest shtëpiak nga data 14.10.2013, e gjerë me datën 13.11.2013, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 400 (katër qind) €, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, ndërsa, nëse dënimin me gjobë refuzon ta paguajë i akuzuari, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burg do t'i llogaritet në shumë prej 20 (njëzetë) €. Të akuzuarin e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 60 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit L.I., av. H.Sh. nga Gjakova, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, në të cilën ishin prezent mbrojtësi i të akuzuarit av. H.Sh., ndërsa edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit, i akuzuari L.I., e dëmtuara A.K. dhe as i dëmtuari F.Q.. Në seancën e kolegjit mbrojtësi i të akuzuarit av. H.Sh., deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës dhe propozimeve si në ankesë, duke shtuar se kërkon nga gjykata që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të merret gjendja shëndetësore e të akuzuarit.

Prokurori i Apelit në propozimin me shkrim PPA.nr.448/2017, datë 13.10.2017, i propozoi gjykatës që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu, as gjendja e fakteve nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë – neni 383 par. 2 të KPPK, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit L.I., theksohet se gjykata e shkallës së parë, i ka konstatuar shumicën e rrethanave lehtësuese, mirëpo, të njëjtat nuk i ka vlerësuar realisht e as në masë të duhur, por faktikisht vetëm i ka numëruar në mënyrë deklarative dhe atë sidomos kur është fjala për rrethana posaçërisht lehtësuese të pranimin të fajësisë, e që ngjashëm ka vepruar edhe me rrethanat tjera lehtësuese, ndërsa rrethanat rënduese i ka marrë parasysh edhe ato rrethana të cilat në rastin konkret as që ekzistojnë, për çka edhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të ashpër me burgim por edhe me gjobë. Pastaj, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, gjykata e shkallës së parë, nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese, se i akuzuari ditën kritike ka qenë i provokuar nga pala e dëmtuar, i cili i ka thënë që të shkojë dhe ta marrë borxhin, pastaj se ditën kritike i akuzuari i ka kërkuar parat e veta, e sidomos duke marrë parasysh edhe gjendjen shëndetësore të akuzuarit, i cili para disa viteve ka pësuar aksident të rëndë në trafik,

atëherë, konsideron se të akuzuarit është dashur t'i shqiptohet dënim më i butë se që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe atë konform dispozitave të nenit 73 të KPK. Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të bazuara, nga se me ankesë nuk cekët asnjë rrethanë konkrete lehtësuese që do të ndikonte drejtpërdrejt në zbutjen e mëtutjeshme të dënimit, por vetëm në mënyrë të përgjithësuar konstatohet se dënimi është i ashpër, ndërsa, disa nga rrethanat lehtësuese që cekën nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, janë pothuajse të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka pasur parasysh dhe pikërisht si rezultat i rrethanave në fjalë, pra, edhe pranimin të fajësisë, gjykata e shkallës së parë, edhe ka shqiptuar dënime nën minimumin e paraparë ligjorë të veprës penale, pra, duke zbatuar kështu dispozitat e parapara për zbutje të dënimit nga nenet 75 dhe 76 të KPK.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është kryer vepra penale, por edhe faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë për vepra të ngjashme penale- pra, për grabitje, atëherë rezulton se dënimin të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm, është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit e po ashtu edhe në funksion të preventivës gjeneralë dhe individuale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK.

Nga sa u parashtrua më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS **PAKR.nr.478/2017, më 01.12.2017**

Procesmbajtësja,
Leonita Lajçi

Anëtarët e kolegjit,
1. _____
Xhevdet Abazi
2. _____
Have Haliti

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj